

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Studim Projektim Ndërtim i rrjetit kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërcisht i Sipërm”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79415200-8 Shërbime të konsulencës në projektim

VLERA E FONDIT LIMIT 11,213,524 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh.

Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit, sipas shkreses së Agjensia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, ku AKUM ka planifikuar objektin: miratuar **Studim Projektim Ndërtim i rrjetit kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërcisht i Sipërm**, në vlerat Buxheti për **2023 : 2,691,246 lekë me tvsh dhe Buxheti 2024: 8,000,000 lekë me tvsh.**

** Financimi i plotë i Studim Projektimit do të kryhet në varësi të vënies në dispozicion të fondeve të planifikuara në Buxhetin e Shtetit*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Peqin, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure eshte "Sherbim Konsulence", përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku percaktohet se: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022) të paraqitura në autoritet përkatëse përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet. Ku te pakten ne dy bilancet te njepasnjeshme , nuk ka raport negative ndermjet aktivitet dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, me një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me entet publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me entin publik, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar ose
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 30% të fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

- **5 b,** Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- **5 c,** Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.
- **6 a,** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- **8 a,** Rivelime inxhinierike.
- **8 b,** Rilevime inxhinierike kadastrale.(*ne detyren e projektimit ne rubriken kerkesat qe duhet te zgjidhe projekti pika 7*)
- **8 c,** Sisteme GIS.
- **8d,** Bazamente gjeodezike.(*ne detyren e projektimit ne rubriken kerkesat qe duhet te zgjidhe projekti pika 15*)
- **9 d,** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet *ne detyren e projektimit ne rubriken kerkesat qe duhet te zgjidhe projekti pika 14*
- **9/e** Studime e projektme hidrogjeologjike

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet te sjellin Liçencat e rinovuara ne zbatim te ketij vendimi.***

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORIA E KËRKUAR</i>	<i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
5b	Projektim Furnizim me ujë –kolektorë shkarkimi.	Bazuar në detyra e projektimit, parashikohet realizimi , si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
5c	Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në detyra e projektimit , parashikohet realizimi i i rrjetit te ujesjellesit ne zonat rurale
8 – a	Rilevime inxhinierike	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet te beje azhornimin e rruges, te jepet plani I piketimit dhe verifikimi paraprak ne terren dhe sondime per sakesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimi si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

8-b	Rilevime inxhinierike kadastrale.	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje azhornimin e rruges, të jepet plani I piketimit dhe verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8-c	Sisteme GIS.	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi në hartimin e projektit duhet të jetë i licensuar në sistemet GIS, pasi aplikacionet GIS ndihmojnë në për të realizuar dhe projektuar si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8-d	Bazamente gjeodezike	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje studime gjeodezike dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9- d	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qendrushmeri të ulet <i>ne detyren e projektimit në rubriken kërkesat që duhet të zgjidhet projekti pika 14</i>	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje studime hidrogjeologjike, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9- e	Studime e projektive hidrogjeologjike <i>ne detyren e projektimit në rubriken kërkesat që duhet të zgjidhet projekti pika 14</i>	Bazuar në detyren e projektimit, projektuesi duhet të beje studime hidrogjeologjike, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

6-a	Projektimi rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore	Bazuar në detyren e projektimit, parashikohet realizimi i rrugëve rurale apo urbane, dytësore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
------------	---	--

--	--	--

Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te drejtuesve teknik, përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, shoqeruar me Diplomë, CV dhe kontratat individuale te punes (të vlefshme),:

- **1(nje) Projektues Inxhinier Ndertimi** me kat **6/a** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- **1(nje) Projektues Vepra Hidroteknike me kat 5/ b**, Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi , me **kat 5/c** Projektim ujesjelles kanalizime urbane-rurale.
- **1(nje) Projektues Gjeodet** me Kat **8 a, b, c, d** (Rilevime inxhinierike. Rilevime inxhinierike kadastrale. Sisteme GIS. Bazamente gjeodezike).
- **1(nje) Projektues gjeolog** me kat **9/d** (Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrushmeri te ulet), **9/e** (Studime e projektme hidrogjeologjike)
- **1(nje) Projektues Inxhinier** per per hartimin e raporteve dhe auditimit te ndikimit ne mjedis.

Argumentim: : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

-Punimet per sherbimin e projekteve strukturore kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndertimit do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) projektues inxhinier ndertimi** , pjese e stafit teknik

-Punimet per sherbimin e projektimit hidroteknik do te jene një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve. Si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) hidroteknik** si pjese e stafit teknik.

-Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet** si pjese e stafit teknik.

-Punimet per sherbimin e projektimit te studimit gjeologjik parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeolog**, si pjese e stafit teknik

-Punimet per raportet mjedisore parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Inxhinier pergjegjes per** hartimin e raporteve dhe auditimit te ndikimit ne mjedis.

Duke qene se kostot e larta të energjisë shpesh kontribuojnë në shpenzime operimi të paqëndrueshme që ndikojnë drejtpërdrejtë shëndetin financiar të shoqërive ujësjellës kanalizime dhe përballueshmërinë e shërbimeve të tyre kerkohet nje inxhinier per evidentimin e kesaj praktike. Inxhinieri mbështet shoqëritë pjesëmarrëse në grumbullimin, auditimin dhe analizimin e të dhënave në lidhje me përdorimin e energjisë dhe zhvillimin e programeve të investimit bazuar në ato të dhëna, për të mbështetur reduktimin e kostove të energjisë dhe rritjen e efijencës së energjisë.

2.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një CV të tij, nje pershkrim i pergjithshem i profilit te veprimtarise, te dhena te pergjithshme lidhur me eksperienca dhe bashkepunime, ne permbushje te projekteve te ndryshme me natyre konsulence, ne fushen e projektimit.

Argumentim: Me ane te permbushjes se ketij kriteri Operatori ekonomik ben nje pasqyrim te te gjithë veprimtarise dhe punes se tij. E cila e ben me te besueshme ne permbushjen e sherbimit qe do te realizohet.

2.7 Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjete)** personave, për periudhën e **3(tre muajve te fundit)** të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen

c) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen 6 muajve te fundit .

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë,ose **ekuivalenten e tyre** përfshirë:

a Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertificate **ISO 9001 -2015** (e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

b) Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertificate **ISO 14001-2015** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 45001-2018** (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit

Argumentim : Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në perputhje janë në perputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

. Operatori ekonomik duhet të ketë një person pjesë e stafit të tij i licencuar për VNM

2.10. Operatori Ekonomik duhet të jetë licencuar nga Q.K.L. për “Shërbime ekspertize në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”

Për të përmbushur kriteret e sipërcituara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimit elektronik, licencat e mësipërme.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kualifikimet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës referuar detyrës së projektimit , natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen, operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat përkatëse.

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

a). Në funksion të zbatimit të kontratës, kërkohet të jenë në dispozicion:

1 (nj) pajisje GPS

1 (nje) pajisje Total Station

2 (dy) mjete, tip fuoristrade

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te paraqese:

- a) Per pajisjet operatori ekonomik duhet te paraqesi dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre, apo marrjen me qira te tij si psh: **Fature tatimore te shitblerjes ose kontrate qiraje te noterizuar.***
- b) Per mjete qe shenohen ne regjistrat publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton **regjistrimin e mjetit/ certificate pronesie, siguracionin e mjetit, certifikaten e kontrollit teknik, , leje qarkullimi.***
- c) Per mjetet e siguruara me qira, dokumentat e mesiperme duhet te shoqerohen edhe me kontraten perkatese noteiale te qirase/leasing/huaperdorjes e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.